



Shpallje për vendë të lirë pune

Shofer

Kohëzgjatja

Pozicion me kohë të plotë

Pagesa

Raporton direkt tek

Vendi i punës

31 Dhjetor 2024, kontratë në përputhje me ligjin vendas.

40 orë / javë

Pagesa në monedhën vendase

Zëvendës Menaxher i Logjistikës Administratës dhe Burimeve Njerëzore

Tiranë, Shqipëri

Afati i fundit për aplikime: 22 Shtator 2024

INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR MISIONIN E TDH NË SHQIPËRI

Terre des hommes (Tdh) Misioni në Shqipëri është një organizatë jofitimprurëse që operon për mbi 30 vjet në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke qenë ndër kontribuuesit kryesorë në ngritjen dhe forcimin e një sistemi kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. Tdh Shqipëri zbaton programe në fushën e migracionit dhe antitrafikimit, mbrojtjes së fëmijëve dhe aksesit në drejtësi. Tdh Shqipëri punon në partneritet të ngushtë me aktorë kombëtarë dhe vendorë në advokimin, forcimin e sistemit dhe zbatimin e modeleve të shërbimeve, qasjeve dhe nismave që synojnë të përmirësojnë mirëqenien e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve në nevojë.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM RRETH PROJEKTIT

Terre des hommes Shqipëri, Projekti “Ngritja e Reziliencës si Instrument Parandalues dhe e Shërbimeve të Reagimit të Menjëhershëm për Fëmijët Viktima të Trafikimit dhe Formave të Rënda të Dhunës” i zbatuar nga Terre des hommes dhe i udhëhequr nga UNICEF-i me mbështetjen e Ambasadës Britanike, ka qëllim të adresojë parandalimin e trafikimit dhe formave të rënda të abuzimit, përfshirë abuzimin seksual. Një komponent kyç i kësaj ndërhyrjeje është përmirësimi i aksesit në shërbimet sociale të bazuara në komunitet për të parandaluar ri-trafikimin dhe për të ofruar mbrojtje për viktimat e mundshme. Një shtyllë tjetër e projektit përqendrohet në forcimin e mbështetjes dhe shërbimeve për përpjekjet e koordinuara në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

QËLLIMI I POZICIONIT:

Shoferi është i pozicionuar në misionin Terre des hommes Shqipëri, në Tiranë, si dhe në çdo vend tjetër, siç kërkohet nga Punëdhënësi dhe kurdo që është e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve dhe nevojave të projektit. Ky pozicion është krijuar me objektivin për të ofruar mbështetje administrative për stafin e Tdh-së në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat e përshkruara më poshtë.

PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Drejton automjetin me profesionalizmin dhe kujdesin më të lartë, në pajtueshmëri me politikat e Tdh, dhe vetëm për qëllime pune.
- Shoqëron stafin e programit në lëvizjet e programuara sipas qyteteve ku kanë angazhime dhe specifikisht njëherë në javë do të duhet të kryej rrugën Tiranë-Bulqizë-Tiranë.
- Përgjegjës për stafin dhe objektet që transportohen nga një vend në një tjetër, duke marrë masa për një transport të sigurt.
- Përgjegjës për mirëmbajtjen e automjetit në kushte sa më të mira e të sigurta.
- Mban përgjegjësi për sigurimin e dokumentacionit të vlefshëm me të cilin mund të levizë automjeti, sipas legjislacionit shqiptar.

- Mban një regjistër të saktë të lëvizjeve, kilometrave dhe detajeve të nevojshme çdo muaj;
- Kontrollon makinën nëse është në gjendje të mirë në baza ditore (kontrollon vajin e motorit dhe frenave, ujën, frenat, presionin e gomave, etj). Sigurohet para çdo lëvizje për gjendjen e mirë të automjetit.
- Parkon dhe mbyll automjetin pas punës në vendin e caktuar, duke siguruar që dokumentacioni dhe çelesat të lihen në zyrë.
- Sigurohet që automjeti nuk është i mbingarkuar.
- Lajmëron menjëherë supervizorin për ndonjë aksidentet, dëmtim, sulm apo vjedhje të automjetit.
- Qendron i përditësuar me informacionin mbi përdorimin e automjeteve në Shqipëri, legjislacionin rrugor dhe të transportit dhe informon mbikëqyrësin për çdo ndryshim legjislativ në lidhje me përdorimin e automjeteve në Shqipëri.

PROFILI JUAJ

- Diplomë e shkollës së mesme
- Të paktën 5 vite eksperiencë pune si shofer
- Patentë e vlefshme shqiptare për drejtim automjeti, preferohet klasi C
- Njohuri shumë të mira të legjislacionit shqiptar për transportin rrugor (Kodi Rrugor)
- Njohuri bazike të gjuhës angleze

PËR TË APLIKUAR

Aplikantët e kualifikuar inkurajohen të dorëzojnë CV-në dhe një letër motivimi me email në adresën alb.hr@tdh.org duke përfshirë në titullin e e-mailit "**Aplikim për Shofer**".

** Ju lutemi vini re se aplikimet e marra pas afatit nuk do të merren parasysh. Për shkak të numrit të lartë të aplikimeve, Tdh nuk është në gjendje t'u përgjigjet të gjithëve individualisht. Ju lutemi vini re se vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.*

Politika e mbrojtjes së fëmijëve:

Tdh (përfshirë anëtarët e stafit, kontraktorët, konsulentët) janë të përkushtuar të respektojnë Politikën e Menaxhimit të Rrezikut Tdh duke përfshirë politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e sigurisë dhe politikën kundër mashtrimit/korrupsionit, politikën e sinjalizimit. Për më shumë ju lutem referojuni lidhjes së mëposhtme <https://www.tdh.org/en/about-us/ethics-committments>.

Pajtueshmëria me RrPMDh (Rregullore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave):

Privatësia juaj është e rëndësishme për ne.

Duke dërguar aplikimin tuaj, ju pranoni që të dhënat tuaja personale të përdoren në procesin e rekrutimit. Çdo informacion personal i dhënë nga ju gjatë procesit të aplikimit do të trajtohet me konfidencialitet dhe do të përdoret vetëm për qëllimin e vlerësimit të kandidaturës suaj për punësim. Jini të sigurt se të dhënat tuaja nuk do të ndahen me palët e treta pa pëlqimin tuaj të qartë dhe do të ruhen në mënyrë të sigurt në përputhje me ligjet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.